



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

C.nr. 603/19

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - trupi gjykues në përbërje nga Gjyqtari Fatmir Baloku –Kryetar dhe gjyqtarëve porotë Sevdije Metrama dhe Nermina Shukurica - anëtarë të trupit gjykues, në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditëses Z. SH., nga Prizreni, kundër të paditurit A. SH., Komuna e Pejës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit M. SH. , Komuna e Pejës, për zgjidhjen e martesës, pas përfundimit të shqyrtimit kryesorë me datë 30.12.2019, jashtë seancës me datë 30.12.2019 bie këtë:

A K T G J Y K I M

ZGJIDHET martesa e lidhur në mes të paditëses Z. SH., nga Prizreni dhe të paditurit A. SH., Komuna e Pejës, e lidhur me datë 20.04.2017, në Zyrën e Gjendjes Civile në ..., me numër rendor 23, numri i referencës...
Secila palë bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja me datën 28.05.2019, në këtë gjykatë ka parashtruar padi për zgjidhje të martesës.

Paditësja në seancën e dt.30.12.2019 ka deklaruar: se edhe me tej mbetet pranë padisë dhe kërkesës se saj, propozoj gjykatës që kërkesëpadija të aprovohet, ndërsa shpenzimet nuk i kërkoj, nuk do të beje ankese kundër aktgjykimit të kësaj gjykatë.

I autorizuari i të paditurit M. SH. në seancën e dt.30.12.2019 ka deklaruar: se nuk e kundërshtojmë kërkesëpadinë e paditëses, ka deklaruar se palët ndërgjyqëse nuk kanë fëmije, e as që do të kenë ne te ardhmen, propozon që e kërkesëpadija e paditëses të aprovohet, ndërsa deklararon se heqim dore nga e drejta e ankesës.

Gjykata në këtë çështje juridike me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat siç vijon:

Ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile, për Z.SH. lëshuar nga zyra e gjendjes civile ne Prizren, me dt.27.05.2019, certifikata e martesës numër rendor 23 lëshuar me dt.27.05.2019, nga zyra e gjendjes civile Prizren.

Gjykata pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 8 të LPK, gjeti se kërkesëpadija e paditëses si i tillë ka mbështetje ligjore dhe duhet aprovuar si i bazuar.

Gjykata duke marr parasysh provat jokontestuese të shqyrtuara gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Paditësja dhe i paditurit kanë lidhë martesë me datë 20.04.2017, në Zyrën e Gjendjes Civile në Baran, nga kjo bashkësi martesore ndërgjyqësit nuk kanë fëmijë të përbashkët dhe me vullnet të lirë pa kurrfarë presioni, janë të pajtimit që të zgjidhet martesë.

Gjykata duke u gjendur pranë kësaj gjendje faktike konsideron se martesë ka humbur qëllimin dhe efektin e vetë për të cilën është lidhë, pasi që martesë lidhet në bazë të dashurisë, besnikërisë si dhe vullnetit reciprok të bashkëshortëve.

Meqë në rastin konkret mungojnë këto elemente qenësore, për ekzistimin e martesës, gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore të caktuara në dispozitën e nenit 68 pika 2 të Ligjit për Familje të Kosovës, ku njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkëputje duke parashtruar padi në gjykatën kompetente.

Për këtë arsye gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi meqë ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet për zgjidhjen e kësaj martesë në mes të bashkëshortëve në kuptim të nenit 69 paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit për Familje të Kosovës.

Pasi që paditësja nuk i kërkoj shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi që secila nga palët të barte shpenzimet e veta të procedurës.

Andaj duke iu referuar të lartë cekurave e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 68 par 2, 69 par 1 dhe par 2, të Ligjit për Familje të Kosovës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË me datë 30.12.2019.

Kryetari i trupit gjykues- Gjyqtari

Fatmir Baloku

UDHËZIM JURIDIK:

**Ky aktgjykim është i formës së prerë
pasi që palët paraprakisht hoqën dorë
nga e drejta e ankesës**

Numri i lëndës: 2019:113788
Datë: 30.12.2019
Numri i dokumentit: 00740892